



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 51, datë 25. 08. 2022

**“DHËNIEN E PËLQIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË, NDËRMJET BASHKISË SKRAPAR SI QIRADHËNËS DHE SUBJEKTIT “VOLTALIA ALBANIE” ME NUIS M11403024T, SI QIRAMARRËS, TË SIPËRFAQES PREJ 126 HA, NË EKONOMINË PYJORE/KULLOSORE DOBRENJ – GJOGOVICË, NË FUNKSION TË “ PROJEKTIT EOLIK”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 25. 08. 2022, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në zbatim të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjit Nr. 57/2020, “Për Pyjet”, Ligjit Nr.9693, datë 19.03.2007, “Për fondin Kulllosor” i ndryshuar, nenit 801 e në vijim të Ligjit Nr.7850, datë 29. 07. 1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-në, Nr.559, datë 29. 07. 2022, “Për përcaktimin e çmimit dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/ përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”, VKM-së Nr. 433, datë 08. 06. 2016, “ Për Transferimin në Pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish - Komunave /Bashkive, Udhëzimi Nr.1, datë 09. 06.2016, i Ministrit të Mjedisit, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulllosor publik”, shkresa (MIE) Nr.7754, datë 28.10. 2021, “Kërkesë për bashkëpunim mbi ankandin për energjinë e erës”

**VENDOSI:**

1. Dhënie e pëlqimit për lidhjen e kontratës së qirasë, ndërmjet Bashkisë Skrapar si qiradhënës dhe subjektit “VOLTALIA ALBANIE” me NUIS M11403024T, si qiramarrës, të sipërfaqes prej 126 ha, në ekonominë pyjore/kullosore Dobrenj - Gjogovicë, në funksion të “Projektit Eolik”.
2. Për lidhjen e kontratës së qirasë dhe përcaktimin e të drejtave të saj , autorizohet Kryetari i Bashkisë
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Kryetari i Bashkisë
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Vendimi u miratua me 11 vota pro , vota kundër - s`ka , vota abstenim – s`ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



**KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK**  
**Edlira SHKËMBI**

